



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:273637
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05726113

K.Dh.Shk.II.nr.254/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditori First Solution L.L.C., me seli në Prishtinë, e përfaqëson me autorizim Armend Deskaj, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Fushë Kosovës, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1341/22 të datës 23.11.2023, me datë 22.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e debitorit Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1341/22 të datës 23.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1341/22 të datës 23.11.2023, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Fushë Kosovës, kundër urdhrorit përmbartimor P.nr.91/21, të datës 16.07.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku me seli në Prishtinë, në pikën II të dispozitivit ka mbete në fuqi urdhrorit përmbartimor P.nr.91/21, të datës 16.07.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku me seli në Prishtinë dhe në pikën III të dispozitivit

shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim, ti paguaj kreditorit në shumë prej 104.00 euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori Ministria e Shëndetësisë, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1341/22 të datës 23.11.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit, duke e shfuqizuar Urdhrin për Përmbarrim P.nr.91/21, të datës 16.07.2021 si dhe të anulohet aktvendimi KPPP.nr.1341/22 të datës 23.11.2023 dhe të kthehet lënda në rivendosje.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtruar kreditori edhe pse të njëjtën e ka pranuar me datën 27.12.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitori është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori First Solution L.L.C., me seli në Prishtinë, me datën 16.07.2021 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbarrimit, kundër debitorit Komuna e Fushë Kosovës, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës për shumën e borxhit prej 8,111.05 €.

Përmbarruesi Privat Afet Mjeku me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.91/21, të datës 16.07.2021, duke lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 45-210-001-20 të datës 22.02.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumën prej 8,111.05 €, me kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbarrimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbarrimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbarrimi

në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajshme.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1341/22 të datës 23.11.2023, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Fushë Kosovës, kundër urdhrorit përmbarrimor P.nr.91/21, të datës 16.07.2021, të lejuar nga Përmbarruesi Privat Afet Mjeku me seli në Prishtinë, në pikën II të dispozitivit ka mbete në fuqi urdhrorit përmbarrimor P.nr.91/21, të datës 16.07.2021, të lejuar nga Përmbarruesi Privat Afet Mjeku me seli në Prishtinë dhe në pikën III të dispozitivit shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim, ti paguaj kreditorit në shumë prej 104.00 euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Në arsyetim të aktvendimit, ka theksuar se në rastin konkret propozimi për përmbarrim i përmbanë të gjitha elementet e parapara nga nenin 29 par. 1 nën para. 1.3 të LPP-së ku përcakton se: *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm dhe dokument i besueshëm sipas këtij ligji është fatura”*, ndërsa neni 29 par. 3 të LPP-së thuhet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë dokumenti - Faturës Nr. 45-210-001-20 të datës 22.02.2021, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarrim, i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta përmban vulën e prokulimit të debitorit, ku plotëson kushtet edhe nga neni 37 të LPP-së ku përcakton se: *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit “* dhe këtë rast i propozimi është bashkëngjitur në origjinal. Andaj, edhe duke qenë së debitori e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën me nr të protokollit Nr. 3189 të datës 23.12.2020, e po ashtu fatura përmban edhe kohën e përmbushjes së detyrimit monetar, si e tillë e njëjta mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe ka tipare të përmbarrueshmërisë.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore me rastin e vendosjes për refuzimin të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se fatura e lëshuar nga ana e kreditorit përmban nënshkrim nga debitori, dhe përcakton kohën e përmbushjes. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 i LPP, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*, ndërsa sipas nenit 37 të LPP-së ka përcaktuar se : *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit“* dhe këtë rast i dokumenti përbarues është në origjinal.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përbarimore, respektivisht është lejuar përbarimi i plotëson kushtet në mënyrë kumulative qe duhet t’i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se fatura e përmban vulën e protokulimit të pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përbarueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Kështu, Gjykata thekson se me plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm mund ta ketë fuqinë e titullit përbarues sepse rezulton se debitori e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Një veprim i tillë, për Gjykatën paraqet pranim të faturës dhe detyrimit.

Dhoma e shkallës së dytë vlerësoj pretendimet ankimore lidhur me at se fatura në fjalë veç se është përmbushur me marrëveshjen me kreditorin, por një pretendim të till e refuzoj si të pa bazuar për shkak se debitori nuk i ka bashkangjitur transaksionet bankare apo ndonjë provë tjetër me të cilët do të vërtetonin se mjetet e lejuar nga Ministria e Financave-Financa e Thesarit të Kosovës janë bartur tek kreditori apo te përmbaruesi privat pasi që në këto urdhërpagesë të lëshuar nga Ministria e Financave-Financa e Thesarit të Kosovës rezulton se vetëm janë aprovuar pagesa e faturës në fjalë, por jo që janë ekzekutuar ato mjete, po ashtu kjo gjykatë ka vlerësuar edhe pretendimin tjetër ankimore lidhur me at se lidhur me marrëveshjen me kreditorin e kemi njoftu përmbaruesin privat Afet Mjeku, por përmbaruesi privat nuk e ka njoftuar gjykatë për një marrëveshje të till apo për ndonjë pagesë të till gjegjësisht për përmbushjen e obligimit nga debitori tek kreditori, andaj një pretendim të till gjykata e refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata e dhomës së shkallës së dytë vlerëson se në procedurën përbarimore organi përmbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, duke marr parasysh edhe pretendime të tjera ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë
K.Dh.Shk.II.nr.254/24 dt. 22.05.2024

Gjyqtarja
Franciska Zhitija Ymeri